



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 05.05.2026

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik në zbatim të përcaktimeve të neneve 23, 24 dhe 30 të ligjit nr.10221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me vendimin nr.3 datë 03.03.2026 rishpalli vakancën për pozicionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioni ftoi të gjithë individët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 24 dhe 30 të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, që brenda datës 23 mars 2026, të dorëzonin dokumentacionin e nevojshëm për kandidim. Në zbatim të vendimit të Komisionit, shërbimet e Kuvendit publikuan në faqen zyrtare të institucionit njoftimin përkatës si dhe kushtet e kriteret që duhet të plotësonin kandidatët.

Në përfundim të afatit të përcaktuar për dorëzimin e dokumentacionit depozituan kandidaturat:

- | | |
|---------------------|-------------------|
| 1. Alfred Balla | 5. Genta Tafa |
| 2. Brikena Luto | 6. Rozeta Ivanova |
| 3. Brunilda Menalla | 7. Sonila Hysi |
| 4. Ermonela Xhafa | |

Në zbatim të nenit 111, pika 2, shkronja c, të Rregullores, Komisioni caktoi datat 7 dhe 8 prill për zhvillimin e dëgjësive të hapura publike me kandidatët e vetëofruar. Për këtë qëllim, me shkresën nr.1294/2, datë 02.04.2026, u njoftuan grupet parlamentare dhe deputetët jashtë grupeve parlamentare, për marrjen pjesë në seancat dëgjimore.

Në mbledhjen e datës 7 prill 2026, me vendimin nr. 5 “Për dëgjësën e kandidatëve të vetofruar për pozicionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioni vendosi të zhvillojë seancën dëgjimore në datë 8 prill vetëm me kandidatët e vetëofruar të cilët nuk janë dëgjuar në shpalljen e parë për këtë pozicion. Konkretisht Z. Alfred Balla, Znj. Brikena Luto dhe Znj. Rozeta Ivanova. Në dëgjësë u paraqit vetëm kandidatja znj. Brikena Luto e cila gjatë seancës prezantoi përvojën profesionale dhe iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioni me shkresën nr.1294/3 datë 08.04.2026, përcolli informacionin për grupet parlamentare dhe deputetëve jashtë tyre, në lidhje me kandidatët e vetëofruar si dhe i informoi që mbështetja e kandidatëve duhet të paraqitet brenda datës 24 prill me qëllim vijimin e procedurës parlamentare.

Në zbatim të pikës 2 të nenit 23 të ligjit nr.10221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste me shkresën nr.1732 prot., datë 20.04.2026 ka depozituar mbështetjen me nënshkrime për kandidaturën e znj. Genta Tafa.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik, në mbledhjen e datës 05 maj 2026, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në përputhje me përcaktimet e nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, mori në shqyrtim mbështetjen e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për kandidaturën e znj. Genta Tafa.

Në përfundim të diskutimeve Komisioni vlerësoi se kandidatura e propozuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 24 dhe 30 të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Përfundime

Komisioni me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje, vendosi t’i përcjellë për vendimmarrje seancës plenare kandidaturën e znj. Genta Tafa për Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas projektvendimit që i bashkëlidhen këtij raporti.

Sipas përcaktimeve të nenit 23 të ligjit nr.10221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri zgjidhet nga shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Para marrjes së detyrës, Komisioneri bën betimin para Kuvendit.

Neni 25 i ligjit të sipër cituar përcakton se Komisioneri zgjidhet për një mandat prej pesë vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

NËNKRYETARE

Iris LUARASI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT VENDIM
PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 23, 24 dhe 25 të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Zgjedhjen e znj .Genta Tafa Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Niko PELESHI

Miratuar në datën